



2022- 2023

Fizioterapi

Bachelor

Programi i ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Fizioterapi” synon të përgatisë profesionistë në fushën e rehabilitimit, të cilët ofrojnë shërbime profesionale rehabilituese individuale dhe në komunitet.

Profesionistët që priten të formohen nëpërmjet këtij program studimi do të jenë të aftë të ushtrorin profesionin e tyre, në nivel makro, mezo dhe mikro, në shërbim të individëve, familjeve, grupeve, komuniteteve. Për të hartuar programin e studimit u morën në konsideratë të gjitha kërkesat e detyrimit ligjor që rrjedhin nga legjislacioni i arsimit të lartë në vend, nga legjislacioni i lidhur me ushtrimin e profesioneve të rregulluara por edhe përvoja e programeve ndërkombëtare në fushën e fizioterapisë.

Programi Bachelor në Fizioterapi synon ti pajisë studentët me njohuritë, aftësitë dhe teknikat e nevojshme për të ofruar një llojshmëri shërbimesh për problematika të ndryshme shëndetësore por edhe një varietet teknikash dhe grupe të ndryshme pacientësh. Zhvillimi i aftësive dhe kompetencave profesionale realizohet duke kombinuar aftësimin teorik bazë karakterizues e ndërdisiplinor, aftësimin teknik nëpërmjet një grupi lëndësh të lidhura me teknikat specifike të fizioterapisë dhe aftësimin praktik në qendrat spitalore dhe klinikat, pjesë e rrjetit të bashkëpunëtorëve të UniBa.

Kohëzgjatja & Forma e studimit

- ✓ Studime me kohë të plotë
- ✓ Kohëzgjatja normale e studimeve në program 3 vite akademike
- ✓ Kohëzgjatja maksimale e studimeve në program 6 vite akademike

Në përfundim të programit mësimor studenti aftësohet të:

1. Të ketë aftësi të kuptojë nga ana thelbësore dhe aplikative një situatë klinike të fispatologjive të sistemeve, aparateve dhe organeve të ndryshme.
2. Të njohë problemet klinike kryesore të lidhura me patologjitë e ndryshme në sektorët e mjekësisë rehabilituese.
3. Të njohë e metodologjitë rehabilituese të ndryshme.
4. Të hartojë ndërhyrje parandaluese, terapeutike dhe rehabilituese të sëmundjeve në bashkëpunim me ekipet multidisiplinare
5. Të përshtasë ndërhyrjet terapeutike me diagnozat dhe përshkrimet mjekësore, sipas karakteristikave të pacientit.
6. Të verifikojë rezultatet e adaptimit të protezave dhe të aparateve të rehabilitimit të diferencuara bazuar në tipin e disabilitetit (motorik, konjitiv).

Mundësi Punësimi

- ✓ Institucione të ofrimit të shërbimit shëndetësor parësor publike dhe jopublike
- ✓ Institucione spitalore publike dhe jopublike
- ✓ Institucione arsimore
- ✓ Institucione multidisiplinore
- ✓ Grupe sportive
- ✓ Ofrim shërbimi në komunitet (shtëpi)
- ✓ Organizata jofitimprurëse

Kurrikula

- Teknika rehabilitimi në Neurologji
- Teknika rehabilitimi në Sëmundjet e Brendshme
- Teknika rehabilitimi në Pediatri
- Teknika trajtimi në Fizioterapi 1
- Teknika rehabilitimi në Kirurgji & Onkologji
- Teknika rehabilitimi në Orto-traumatologji
- Masazhi sportiv
- Teknika rehabilitimi në djegie plastike
- Teknika rehabilitimi në Uro-gjinekologji-obstetrike

Adresa:

Kampus 1, Rruga e Kosovarëve, Cel: +355 69 20 62 086 | +355 69 20 41 222
E-mail: info@umb.edu.al | admissions@umb.edu.al | **Web:** www.umb.edu.al
Kampus 2, Rruga Frang Bardhi, Selitë | Cel: +355 69 20 67 247

